



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 19884 prot.

Shkodër, më 03 . 08 . 2026

**VENDIM
Nr. 61, datë 29.07.2026**

PËR MIRATIM E GJERËSISË SË ZONAVE TË REZERVUARA PËR VARREZAT

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; në nenin 4 të ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 29.10.2014, “Për miratimin e Rregullores Teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”; në kreun VII të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 16.10.2017, dhe rishikuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 9, datë 28.12.2020; në mendimin pozitiv të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor nr. 532/1 prot., datë 01.07.2026, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë gjerësinë e zonës së rezervuar (brezit sanitar) për varrezat në territorin e Bashkisë Shkodër, prej 101 (njëqind e një) metrash, të matur nga kufiri i varrezës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25
Vota Kundër 8
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 30.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



Oltion LULI

Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al